



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 5 mars 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesat e Prokurorisë për Leje për Apelim të Vendimit mbi
Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 153 (F02111)**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 45(2) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 shkurt 2024, Trupi Gjykues lëshoi Vendimin mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të dëshmitarëve W04016, W04019, W04044, W04305, W04361, W04722, W04816, W04850, W04851, dhe W04852 sipas rregullës 153 ("Vendimi i Kundërshtuar").¹

2. Më 15 shkurt 2024, Mbrojtja e z. Thaçi ("Mbrojtja e Thaçit"), Mbrojtja e z. Selimi ("Mbrojtja e Selimit") dhe Mbrojtja e z. Krasniqi ("Mbrojtja e Krasniqit") dorëzuan kërkesë për leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar ("Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit").²

3. Në të njëjtën ditë, Mbrojtja e z. Veseli ("Mbrojtja e Veselit") dorëzoi një kërkesë më vete për leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar ("Kërkesa e Veselit").³

¹ F02111, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve W04016, W04019, W04044, W04305, W04361, W04722, W04816, W04850, W04851, dhe W04852 sipas Rregullës 153*, 8 shkurt 2024, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F02111/RED).

² F02128, Mbrojtja, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 153* (F02111), 15 shkurt 2024, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F02128/RED).

³ F02131, Mbrojtja, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 153* (F02111), 15 shkurt 2024, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 16 shkurt 2024, F02131/RED).

4. Më 28 shkurt 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi një përgjigje të konsoliduar ("Përgjigja e ZPS-së") ndaj Kërkesës së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit dhe Kërkesës së Veselit (bashkërisht "Kërkesat e Mbrojtjes").⁴
5. Më 1 mars 2024, Mbrojtja e Veselit dorëzoi kundërpërgjigjen e saj ndaj Përgjigjes ("Kundërpërgjigja e Veselit").⁵
6. Mbrojtja e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit nuk u kundërpërgjigj ndaj Përgjigjes së ZPS-së.

II. PARASHTRIME

7. Ekipet e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit kërkojnë për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar lidhur me tri pikat në vijim:

1. Nëse Trupi Gjykses bëri gabim juridik që zbatoi një standard tejet të ulët për pranimin e provave të W04722-shit dhe W04816-ës sipas rregullës 153, në kundërshtim me faktorët kundër pranimin të tyre të përcaktuar në rregullën 153(1)(b) dhe kriterin e "rrethanave të jashtëzakonshme" që duhet zbatuar për pranimin e provave sipas rregullës 153(3) ("pika e parë e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit");
2. Nëse Trupi Gjykses bëri gabim juridik dhe/ose faktik dhe/ose shpërdoroi diskrecionin e tij kur konstatoi se për temat shtesë të propozuara nga Mbrojtja për marrjen në pyetje të W04722-ës dhe W04816-ës nuk ishte e domosdoshme prania e dëshmitarëve në gjykim ("pika e dytë e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit"); dhe
3. Nëse Trupi Gjykses bëri gabim juridik dhe/ose faktik kur pranoi një komunikim që pretendohet të jetë përgjuar si provë materiale shoqëruese të provave të W04816-ës ("pika e tretë e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit").⁶

⁴ F02156, Prokurorja e Specializuar, Përgjigje e Konsoliduar e Prokurorisë ndaj Kërkesave për Apel F02128 dhe F02131 të Mbrojtjes, 28 shkurt 2024, publike.

⁵ F02159, Mbrojtja, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së Konsoliduar të Prokurorisë (F02156) ndaj Kërkesave për Leje për Apel F02128 dhe F02131 të Mbrojtjes, 1 mars 2024, publike.

⁶ Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 2, 30.

8. Mbrojtja e Veselit kërkon leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar lidhur me dy pikat në vijim që kanë të bëjnë me vendimin e Trupit Gjykues për pranimin e provave të W04722-shit dhe W04816-ës:

1. Nëse Trupi Gjykues nuk zbatoi standardin e duhur ligjor për pranimin e provave sipas rregullës 153 ("pika e parë e Veselit"); dhe
2. Nëse Trupi Gjykues shkeli të drejtën themelore të të akuzuarit për t'u ballafaquar me provat kundër tij kur e pranoi këtë provë sipas rregullës 153 ("pika e dytë e Veselit").⁷

9. Që të katër ekipet e Mbrojtjes së të akuzuarve parashtrojnë se pikat e paraqitura përmbushin standardin për miratimin e lejes për apel sepse ato: (i) burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar, janë mjaftueshëm specifike dhe të identifikueshme dhe nuk përbëjnë thjesht mospajtim me të;⁸ (ii) ndikojnë në zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit;⁹ dhe (iii) zgjidhja e tyre e menjëhershme nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.¹⁰

10. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesat e Mbrojtjes duhet të rrëzohen pasi nuk plotësojnë standardin për miratimin e lejes për apel sipas nenit 45 dhe rregullës 77.¹¹ Sipas ZPS-së, në Kërkesat e Mbrojtjes pretendohet se janë bërë disa gabime juridike ose faktike në zbatimin e rregullës 153, por një shqyrtim më i hollësishëm tregon se Mbrojtja thjesht nuk pajtohet me zbatimin e arsyeshëm dhe korrekt nga Trupi Gjykues të kësaj rregulle.¹² ZPS-ja gjithashtu parashtroi se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se shqyrtimi në apel do të kishte ndonjë ndikim, aq më pak ndikim të konsiderueshëm, në zhvillimin ose rezultatin e gjykimit.¹³

⁷ Kërkesa e Veselit, para. 2-3, 28.

⁸ Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 4-8, 11-18, 23-25; Kërkesa e Veselit, para. 6-24.

⁹ Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 4, 9, 19-21, 26-27; Kërkesa e Veselit, para. 6, 25.

¹⁰ Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 4, 10, 22, 28-29; Kërkesa e Veselit, para. 6, 26.

¹¹ Përgjigja e ZPS-së, para. 1, 22.

¹² Përgjigja e ZPS-së, para. 1.

¹³ Përgjigja e ZPS-së, para. 1.

11. Mbrojtja e Veselit kundërpërgjigjet se përgjigja e ZPS-së: (i) nuk u përgjigjet realisht aspekteve të ngritura në Kërkesën e Veselit;¹⁴ dhe (ii) keqkupton dhe shtrembëron thelbin e Kërkesës së Mbrojtjes.¹⁵ Mbrojtja e Veselit parashton se Kërkesa e Veselit demonstroi qartë gabime juridike të apelueshme.¹⁶ Rrjedhimisht, Mbrojtja e Veselit kërkon miratimin e lejes për apel në përputhje me mjetin juridik të kërkuar në Kërkesën e Veselit.¹⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

12. Sipas nenit 45(2) dhe rregullës 77(2), e drejta për apel lind vetëm nëse është përmbushur standardi për miratimin e lejes parashikuar në këto dispozita. Rregulla 77(2) përcakton se:

Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën, një vendim i menjëhershëm nga ana e panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor.

Trupi Gjykues përfshin përmes referencave dispozitat ligjore mbi standardin ligjor për miratimin e lejes për apel, sikurse është përcaktuar në vendime të mëparshme.¹⁸

¹⁴ Kundërpërgjigja e Veselit, para. 2.

¹⁵ Kundërpërgjigja e Veselit, para. 3.

¹⁶ Kundërpërgjigja e Veselit, para. 4.

¹⁷ Kundërpërgjigja e Veselit, para. 14.

¹⁸ F01237, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë*, 30 janar 2023, para. 7-8; KSC-BC-2020-07, F00423, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesat e ZPS-së për Leje për Apelim të Vendimit F00413 dhe Efekt Pezullues*, 8 nëntor 2021, para. 13-21; F00372, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për Leje për Apelim të Urdhrit F00328*, 15 tetor 2021, para. 15-17; F00484, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit F00470*, 8 dhjetor 2021, para. 4-14. Shih gjithashtu F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel*, 11 janar 2021, para. 6-7, 9-17.

IV. DISKUTIM

13. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykues konstatoi se provat e W04722-shit dhe W04816-ës, që përbëhen nga deklaratat e tyre sipas rregullës 153 dhe prova materiale shoqëruese, janë *prima facie* relevante,¹⁹ autentike,²⁰ dhe me vlerë provuese.²¹ Gjithashtu, Trupi Gjykues konstatoi se pranimi i provave të W04722-shit dhe W04816-ës në vend të dëshmive gojore nuk ka efekt dëmtues të papërligjur sipas përcaktimit të rregullës 138(1),²² dhe se ato prova janë të përshtatshme për t'u pranuar sipas rregullës 153 sepse: (i) janë përgjithësisht përsëritëse të provave të dëshmitarëve të tjerë dhe provave dokumentare, konfirmohen nga dëshmitarë që të akuzuarit kanë pasur dhe do të kenë mundësi t'i marrin në pyetje, si dhe plotësojnë fakte relevante të shqyrtuara në procese të tjera;²³ (ii) përmbushin kriteret e rregullës 153(2);²⁴ (iii) janë me vëllim relativisht të kufizuar dhe nuk janë përsëritëse në masë të tepruar;²⁵ dhe (iv) shërbejnë për vërtetimin e pikave të ndryshme nga veprimet dhe sjellja e të akuzuarve të paraqitura në Aktakuzë.²⁶ Në arritjen e këtij përfundimi, Trupi Gjykues u bind se roli qendror i pretenduar i W04722-shit në këtë çështje gjyqësore dhe informacioni shtesë që Mbrojtja dëshiron të nxjerrë nga W04722 dhe W04816 nuk e bëjnë të domosdoshme praninë e tyre për marrje në pyetje nga pala kundërshtare.²⁷

14. Gjithashtu, Trupi Gjykues konstatoi se pasaktësitë e pretenduara në deklaratat e dëshmitarit sipas rregullës 153 në parim nuk janë arsye e mjaftueshme për të kërkuar marrjen në pyetje të tij nga Mbrojtja, kur janë përmbushur përndryshe kriteret e rregullës 153, sepse ky aspekt ka të bëjë me peshën që do t'u

¹⁹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 55, 57, 64, 66.

²⁰ Vendimi i Kundërshtuar, para. 56-57, 65-66.

²¹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 59, 67.

²² Vendimi i Kundërshtuar, para. 59, 67.

²³ Vendimi i Kundërshtuar, para. 58, 67.

²⁴ Vendimi i Kundërshtuar, para. 58, 67.

²⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para. 58, 67.

²⁶ Vendimi i Kundërshtuar, para. 59, 67.

²⁷ Vendimi i Kundërshtuar, para. 59, 67.

jepet provave përkatëse duke marrë parasysh të gjitha provat në gjykim, dhe jo me pranueshmërinë e tyre.²⁸ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses pranoi provat e W04722-shit dhe W04816-ës në pajtim me rregullat 138(1) dhe 153 pa marrje në pyetje nga pala jothirrëse.²⁹

15. Në analizën e mëposhtme të kërkesave për apel, Trupi Gjykses i ka trajtuar së bashku pikat e paraqitura, sepse pika e parë e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit dhe pika e parë e Veselit identifikojnë dhe shprehin gabime të njëjta që pretendohet se u kryen nga Trupi Gjykses në Vendimin e Kundërshtuar. E njëjta gjë vlen edhe për pikën e dytë të Thaçit, Selimit dhe Krasniqit dhe pikën e dytë të Veselit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do t'i shqyrtojë pikat përkuese së bashku.

A. PIKA E PARË E THAÇIT, SELIMIT DHE KRASNIQIT DHE PIKA E PARË E VESELIT

16. Mbrojtjet e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit parashtrojnë se Trupi Gjykses nuk i trajtoi si duhet faktorët kundër pranimi të deklaratave me shkrim, ose kriterin e rrethanave të jashtëzakonshme për pranimin e deklaratave pa marrje në pyetje nga pala jothirrëse.³⁰ Sipas Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, Trupi Gjykses procedoi mbi bazën që, për sa kohë provat ishin relevante, autentike dhe me vlerë provuese, ato duheshin pranuar, përveç nëse Mbrojtja do të vërtetonte me prova ndonjë kundërshtim të saj ndaj pranimi të tyre.³¹ Në mënyrë të ngjashme, Mbrojtja e Veselit parashton se Trupi Gjykses gaboi kur vlerësoi se, nëse ZPS-ja do të demonstronte me sukses se provat kishin lidhje me lëndën, ishin autentike *prima facie* dhe përmbushnin një kusht të rregullës 153(1)(a), kjo mjaftonte për t'i bërë provat të pranueshme.³² Sipas Mbrojtjes së Veselit, Trupi Gjykses gjithashtu gaboi:

²⁸ Vendimi i Kundërshtuar, para. 59.

²⁹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 60, 68, 93(b).

³⁰ Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 7. *Shih gjithashtu* Kërkesën e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 6.

³¹ Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 7.

³² Kërkesa e Veselit, para. 8. *Shih gjithashtu* Kërkesën e Veselit, para. 9, 15-16.

(i) që përmbysi detyrimin juridik të përcaktuar në rregullën 153;³³ (ii) që nuk dha arsye pse Trupi Gjykses u bind se kriteret për zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të gjykimit bënin veçanërisht të domosdoshëm pranimin e deklaratave të W04816-ës ose të W04722-shit;³⁴ (iii) që konsideroi se fakti që një dëshmitar nuk jep prova për veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve është faktor në favor të pranimit të provave;³⁵ dhe (iv) që nuk e konsideroi ekzistencën e mospërputhjeve të pretenduara si faktor kundër pranimit të provave sipas rregullës 153.³⁶

17. ZPS-ja përgjigjet se, kundërshtimi i standardit për pranimin e provave nga Mbrojtja e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit përbën thjesht mospajtim me përfundimin e arsyeshëm dhe korrekt të Trupit Gjykses se provat ishin të pranueshme në bazë të rregullës 153.³⁷ ZPS-ja gjithashtu pretendon se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes, Trupi Gjykses nuk u shpreh se relevanca dhe autenticiteti *prima facie* i provave ishin i vetmi faktor vendimtar për pranimin e provave, por e vlerësoi dëshminë e propozuar në kuadër të tërësisë së kriterëve të rregullës 153.³⁸

18. Mbrojtja e Veselit kundërpërgjigjet se në Vendimin e Kundërshtuar Trupi Gjykses nuk i balancoi aspektet përkatëse në mënyrë transparente dhe të arsyetuar.³⁹

19. Sikurse u përmend më lart, në Vendimin e Kundërshtuar Trupi Gjykses konstatoi se krahas përmbushjes së kriterëve të rregullës 138(1), provat e W04722-shit dhe W04816-ës: (i) shërbejnë për të vërtetuar aspekte që nuk kanë të bëjnë me veprimet dhe sjelljet e të akuzuarve sipas Aktakuzës; dhe (ii) janë përgjithësisht përsëritëse të provave të dëshmitarëve të tjerë dhe provave të tjera dokumentare,

³³ Kërkesa e Veselit, para. 10-11.

³⁴ Kërkesa e Veselit, para. 12-13.

³⁵ Kërkesa e Veselit, para. 14.

³⁶ Kërkesa e Veselit, para. 17.

³⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 4. *Shih gjithashtu* Përgjigjen e ZPS-së, para. 5.

³⁸ Përgjigjja e ZPS-së, para. 19, që i referohet Kërkesës së Veselit, para. 8. *Shih gjithashtu* Përgjigjen e ZPS-së, para. 20.

³⁹ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 6. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen e Veselit, para. 5.

konfirmohen nga dëshmitarë që të akuzuarit kanë pasur dhe do të kenë mundësi t'i marrin në pyetje, si dhe plotësojnë fakte relevante të shqyrtuara në procese të tjera.⁴⁰ Këto konstatime lidhen me faktorë në favor të pranimit të provave në përputhje me rregullën 153(1)(a).

20. Trupi Gjykues u bind gjithashtu se, në kundërshtim me argumentet e Mbrojtjes në lidhje me domosdoshmërinë e marrjes në pyetje të W04722-shit dhe W04816-ës nga pala jothirrëse: (i) pasaktësitë e pretenduara në deklaratat e dëshmitarit sipas rregullës 153, në vetvete, nuk e bëjnë të domosdoshme marrjen në pyetje të dëshmitarit nga pala kundërshtare, kur kushtet e tjera të rregullës 153 përndryshe janë përmbushur; (ii) pranimi i provave të W04722-shit dhe W04816-ës në vend të dëshmisë gojore pa marrje në pyetje nga pala jothirrëse nuk ka efekt dëmtues të papërligjur; dhe (iii) provat e W04722-shit dhe W04816-ës ishin të përshtatshme për t'u pranuar pa marrje në pyetje nga pala kundërshtare.⁴¹ Këto konstatime lidhen me faktorët kundër pranimit të provave sipas rregullës 153(1)(b) dhe trajtojnë nëse do të ishte rrjedhimisht e domosdoshme marrja në pyetje e dëshmitarëve sipas rregullës 153(1)(b)(iii) dhe (3).

21. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues vlerësoi përshtatshmërinë e pranimit të provave të W04722-shit dhe W04816-ës në vend të dëshmisë gojore duke u bazuar në përcaktimet e rregullave 138(1) dhe 153(1)-(3), duke kryer edhe vlerësimin e faktorëve në favor dhe kundër pranimit të tyre.⁴²

22. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se, në kundërshtim me parashtimet e Mbrojtjes së Veselit,⁴³ ai dha arsye të hollësishme pse u bind për pranueshmërinë e provave të W04722-shit dhe W04816-ës dhe për përshtatshmërinë e tyre në pajtim me rregullën 153.⁴⁴ Në veçanti, Trupi Gjykues përcaktoi shprehimisht se

⁴⁰ *Shih më lart* para. 13.

⁴¹ *Shih më lart* para. 13-14.

⁴² *Contra* Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 6-7; Kërkesa e Veselit, para. 8-9, 15-17.

⁴³ Kërkesa e Veselit, para. 12-13; Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 5-6.

⁴⁴ *Shih më lart*, para. 13-14, dhe referencat në Vendimin e Kundërshtuar.

“detyrimi për të vërtetuar përmbushjen e kushteve të pranueshmërisë sipas rregullës 153 i takon ZPS-së”.⁴⁵ Për më tepër, Trupi Gjykses mori parasysh faktin që dëshmitari nuk jep prova në lidhje me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve si një element të rëndësisë në tërësi të provave të dëshmitarit për çështjen e ZPS-së, që përcaktohet shprehimisht në rregullën 153(1)(b)(ii).⁴⁶ Së fundi, Trupi Gjykses rikujtoi shprehimisht se, pasaktësitë e pretenduara në deklaratën e një dëshmitari sipas rregullës 153, në vetvete, pa faktorë të tjerë, nuk janë bazë e mjaftueshme për ta bërë të domosdoshme marrjen në pyetje të dëshmitarëve nga pala jothirrëse, kur kriteret e tjera për pranimin e provave pa marrje në pyetje nga pala jothirrëse janë përmbushur.⁴⁷

23. Pasi ka konstatuar se dëshmitë e W04722-shit dhe W04816-ës përmbushin kriteret sipas rregullave 138 dhe 153, dhe në mungesë të faktorëve kundër pranimi të provave të W04722-shit dhe W04816-ës, Trupi Gjykses i pranoi ato si prova në vend të dëshmisë gojore pa marrje në pyetje të dëshmitarëve nga pala jothirrëse.

24. Trupi Gjykses është i mendimit se pika e parë e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit dhe pika e parë e Veselit shtrembërojnë konstatimet e Trupit Gjykses dhe përbëjnë thjesht mospajtim me to. Për më tepër, Mbrojtja e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit po përpiqet të debatojë përsëri pranimin e provave të W04722-shit dhe W04816-ës sipas rregullës 153, duke përsëritur në masë të madhe kundërshtimet e paraqitura më herët lidhur me Vendimin e Kundërshtuar mbi rëndësinë e pretenduar të këtyre dëshmitarëve për provat e ZPS-së. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se pika e parë e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit dhe pika e parë e Veselit përbëjnë tema më vete që burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar.

⁴⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para. 59.

⁴⁶ Vendimi i Kundërshtuar, para. 59, 67. *Shih gjithashtu* rregullën 153(1), fjalinë e parë, gjysmën e fjalisë së fundit. *Contra* Kërkesa e Veselit, para. 10-11, 14.

⁴⁷ Vendimi i Kundërshtuar, para. 59.

25. Mbi këtë bazë, kushtet e tjera për miratimin e lejes për apelim që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) lidhur me pikën e parë të Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, nuk është e nevojshme të trajtohen. Rrjedhimisht, kërkesa për leje për apelim e pikës së parë të Thaçit, Selimit dhe Krasniqit dhe pikës së parë të Veselit rrëzohet.

B. PIKA E DYTË E THAÇIT, SELIMIT DHE KRASNIQIT DHE PIKA E DYTË E VESELIT

26. Ekipe të Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit parashtojnë se, duke i mohuar Mbrojtjes mundësinë e marrjes në pyetje të W04722-shit dhe W04816-ës për tema të identifikuar që lidhen me provat e tyre, besueshmërinë e tyre, si dhe me vetë tërësinë e provave të Mbrojtjes, Vendimi i Kundërshtuar cenoi në mënyrë shproporcionale të drejtën themelore të të akuzuarve për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tyre, ose që këta të fundit të merren në pyetje në emër të tyre, dhe për të paraqitur prova të afta për të hedhur poshtë akuzat.⁴⁸ Në mënyrë të ngjashme, Mbrojtja e Veselit parashton se ekziston prezumimi në favor të mundësisë për marrjen në pyetje të dëshmitarëve nga pala jothirrëse dhe se Mbrojtjes duhet t'i jepet më shumë përparësi kur ajo argumenton se dëshmitari duhet të paraqitet për t'u marrë në pyetje prej saj.⁴⁹

27. ZPS-ja përgjigjet se pika e dytë e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit nuk është e apelueshme sepse i mungon saktësia, dhe se ajo paraqitet si pretendim për gabim, kur në fakt shpreh vetëm mospajtim.⁵⁰ Më tej, ZPS-ja parashton se, duke kërkuar që t'i jepet "më shumë përparësi" për të marrë në pyetje dëshmitarët, pika e dytë e Veselit përbën, faktikisht, kundërshtim ndaj rregullës 153 në përgjithësi, dhe jo ndaj mënyrës së zbatimit të saj në vendimin e Trupit Gjykses.⁵¹

⁴⁸ Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 11. *Shih gjithashtu* Kërkesën e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 12-16.

⁴⁹ Kërkesa e Veselit, para. 22-23.

⁵⁰ Përgjigja e ZPS-së, para. 8. *Shih gjithashtu* Përgjigjen e ZPS-së, para. 7.

⁵¹ Përgjigja e ZPS-së, para. 21.

28. Mbrojtja e Veselit kundërpërgjigjet se kur Mbrojtja argumenton me ndershmëri se një dëshmitar është unik, qendror, ose i rëndësishëm për provat dhe argumentet e saj, nuk mund të jetë e drejtë që ai dëshmitar të pranohet sipas rregullës 153, pa pasur prova që tregojnë ekzistencën e rrethanave të jashtëzakonshme.⁵²

29. Siç tregohet më lart, në kuadër të konstatimit se provat e W04722-shit dhe W04816-ës ishin të pranueshme sipas rregullave 138 dhe 153, Trupi Gjykses konstatoi se temat shtesë për të cilat Mbrojtja dëshiron t'u bëjë pyetje dy dëshmitarëve nuk e bënin të domosdoshme paraqitjen e tyre në gjykim për t'u marrë në pyetje prej saj.⁵³ Trupi Gjykses e vlerësoi përshtatshmërinë për pranim të provave të W04722-shit dhe W04816-ës në vend të dëshmimeve gojore në bazë të përcaktimeve të rregullës 153(1)-(3).⁵⁴ Megjithatë, ndryshe nga sa parashton ZPS-ja lidhur me pikën e dytë të Thaçit, Selimit dhe Krasniqit dhe pikën e dytë të Veselit,⁵⁵ aspekti nëse Trupi Gjykses gaboi apo shpërdoroi diskrecionin në arritjen e këtij konstatimi përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se pika e dytë e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit dhe pika e dytë e Veselit burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar.

30. Sa i përket ndikimit të ndjeshëm në zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procesit apo në rezultatin e gjykimit, Trupi Gjykses vë në dukje se, aspekti nëse Trupi Gjykses gaboi apo shpërdoroi diskrecionin kur konstatoi se paraqitja e W04722-shit dhe W04816-ës për marrje në pyetje nga pala jothirrëse nuk ishte e domosdoshme, mund të ndikojë në mundësinë e të akuzuarve për të verifikuar provat e dëshmitarëve përmes marrjes në pyetje, apo për të nxjerrë prova me gjasë shfajësuese që Mbrojtja pretendon se do të ishin relevante për argumentet e saj. Rrjedhimisht, në kundërshtim

⁵² Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 9. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen e Veselit, para. 8, 10-12.

⁵³ *Shih më lart* para. 13.

⁵⁴ *Shih më lart* para. 19-21.

⁵⁵ Përgjigjja e ZPS-së, para. 7-8, 21.

me parashtrimet e ZPS-së,⁵⁶ Trupi Gjykses është bindur se Mbrojtja ka demonstruar që pika e dytë e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit dhe pika e dytë e Veselit do të ndikonin në kryerjen e drejtë të procesit. Kjo pavarësisht nga fakti se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se këta dëshmitarë mund të jepnin dëshmi në mbështetje të argumenteve të saj.

31. Sa i përket aspektit nëse një vendim i menjëhershëm për këtë pikë nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin, Trupi Gjykses vëren se konstatimi i tij se nuk është e domosdoshme që W04722 dhe W04816 të paraqiten në gjykim për t'u marrë në pyetje nga Mbrojtja për temat shtesë të saj: (i) nuk ishte i vetmi faktor që çoi në pranimin e provave të tyre sipas rregullës 153;⁵⁷ dhe (ii) sidoqoftë, ai çoi thjesht në pranim të provave vlera e të cilave do të peshohet si duhet në fund të gjykimit, në kuadër të tërësisë së provave dhe duke mbajtur parasysh se verdikti i fajësisë nuk mund të bazohet vetëm, ose në masë vendimtare, në deklaratën e një dëshmitari që Mbrojtja nuk ka pasur mundësi ta pyesë.⁵⁸ Më tej, Trupi Gjykses gjykon se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit,⁵⁹ nuk ka asnjë paqartësi lidhur me kuadrin e diskrecionit të Trupit Gjykses për pranimin e deklaratave të mëparshme në vend të dëshmisë gojore. Dhomat e apelit në tribunalët *ad hoc* dhe në Dhomat e Specializuara kanë konfirmuar se gjykatësit e shkallës së parë kanë shkallë të gjerë diskrecioni për të marrë vendime për pranimin e provave bazuar në rrethanat e çështjes, dhe se dhomat e apelit nuk ndërhyjnë lehtësisht në këto vendime.⁶⁰

⁵⁶ Përgjigjja e ZPS-së, para. 12, 14-15.

⁵⁷ *Shih më lart* para. 13-14.

⁵⁸ Rregulla 140(4)(a).

⁵⁹ *Shih* Kërkesën e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 22.

⁶⁰ *Shih* KSC-CA-2022-01, F00114, Gjykata e Apelit, Aktgjykimi i Apelit, 2 shkurt 2023, para. 35; *shih gjithashtu* ICTY, *Prosecutor v. Tolimir et al.*, IT-04-80-AR73.1, Appeals Chamber, [Decision on Radivoje Miletić's Interlocutory Appeal Against the Trial Chamber's Decision on Joinder of Accused](#), 27 January 2006, para. 4; *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 20 February 2001, para. 533; ICTR, *Nyiramasuhuko v. Prosecutor*, ICTR-98-42-AR73.2, Appeals Chamber, [Decision on Pauline Nyiramasuhuko's Appeal on the Admissibility of Evidence](#), 4 October 2004, para. 5.

32. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka demonstruar se si një vendim i menjëhershëm për pikën e dytë të Thaçit, Selimit dhe Krasniqit dhe pikën e dytë të Veselit nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.⁶¹

33. Rrjedhimisht, kërkesa për leje për apelim të pikës së dytë të Thaçit, Selimit dhe Krasniqit dhe pikës së dytë të Veselit hidhet poshtë.

C. PIKA E TRETË E THAÇIT, SELIMIT DHE KRASNIQIT

34. Ekipet e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit parashtrojnë se Trupi Gjykses gaboi që pranoi një material të paraqitur si provë materiale shoqëruese e deklaratës së W04816-ës.⁶² Ata argumentojnë se kjo provë nuk është pjesë e pandashme ose e domosdoshme e deklaratës së W04816-ës⁶³ dhe se Trupi Gjykses nuk iu përgjigj thelbit të kundërshtimeve të tyre e as vlerësoi si duhet pranueshmërinë e provës materiale shoqëruese më vete nga provat e tjera.⁶⁴ Ekipet e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit parashtrojnë, rrjedhimisht, se pika e tretë ka të bëjë me zbatimin si duhet të kriterëve të pranueshmërisë, si dhe me detyrimin për të dhënë vendim të arsyetuar.⁶⁵

35. ZPS-ja përgjigjet se ekipet e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit: (i) nuk demonstrojnë asnjë gabim në trajtimin e provave materiale të W04816-ës nga Trupi Gjykses; dhe (ii) shtrembërojnë Vendimin e Kundërshtuar. Rrjedhimisht, ZPS-ja argumenton se kjo pikë nuk është e apelueshme.⁶⁶

36. Siç u përmend më lart, në Vendimin e Kundërshtuar Trupi Gjykses konstatoi se provat materiale shoqëruese të W04816-ës, ndër të cilat përgjimi që iu tregua

⁶¹ *Contra* Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 22; Kërkesa e Veselit, para. 26.

⁶² Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 23. *Shih gjithashtu* Kërkesën e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 24.

⁶³ Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 23.

⁶⁴ Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 24.

⁶⁵ Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 25.

⁶⁶ Përgjigja e ZPS-së, para. 10-11.

dhe u diskutua me të gjatë intervistës me ZPS-në, përbëjnë pjesë të domosdoshme dhe të pandashme të deklaratës së dëshmitarit sipas rregullës 153.⁶⁷ Gjithashtu, Trupi Gjykses konstatoi se provat e W04816-ës kanë lidhje me lëndën, janë autentike *prima facie* dhe kanë vlerë provuese, nuk kanë efekt dëmtues të papërligjur dhe janë të pranueshme pa marrje në pyetje nga pala jothirrëse, në bazë të rregullës 153.⁶⁸ Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit,⁶⁹ Trupi Gjykses e vlerësoi pranueshmërinë e provave materiale shoqëruese të W04816-ës bazuar si në rregullën 138, ashtu edhe në rregullën 153, dhe u bind për pranueshmërinë e secilës prej tyre sipas atyre rregullave.

37. Trupi Gjykses është i mendimit se pika e tretë e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit përbën thjesht mospajtim me konstatimet e Trupit Gjykses, si dhe përpjekje për të debatuar edhe një herë juridikisht pranimin e provave materiale të W04816-ës sipas rregullës 153. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ekipet e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit nuk kanë arritur të vërtetojnë se pika e tretë e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit përbëjnë temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

38. Rrjedhimisht, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) në lidhje me pikën e tretë të Thaçit, Selimit dhe Krasniqit. Kërkesa për leje për apelimin e pikës së tretë të Thaçit, Selimit dhe Krasniqit hidhet poshtë.

V. VENDIMI

39. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses **HEDH POSHTË** Kërkesat e

⁶⁷ Vendimi i Kundërshtuar, para. 66.

⁶⁸ Vendimi i Kundërshtuar, para. 66-68. *Shih* më lart, para. 13.

⁶⁹ Kërkesa e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 24. *Shih edhe* Kërkesën e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, para. 25.

Mbrojtjes.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E martë, 5 mars 2024

Në Hagë, Holandë.